



Akademia e Kosovës për Siguri Publike

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT

PËRMBAJTJA

1.DEKLARATA E MISIONIT TË INSTITUCIONIT

2.KUSH JEMI NE?

3.ÇFARË OFROJMË NE?

4.CILAT JANË KAPACITETET TONA?

5.CILAT JANË REZULTATET TONA PËR TRE VITET E FUNDIT?

6.VETËVLERËSIMI NË BAZË TË KORNIZËS KOMBËTARE PËR SIGURIMIN E CILËSISË (KKSC).

1.DEKLARATA E MISIONIT

Misioni dhe vizioni i AKSP-së janë formuluar nëpërmjet rolit të saj dhe janë në pajtim me pritshmëritë e të gjitha grupeve të interesit. AKSP-ja në mënyrë të qartë përcakton qëllimin e saj, e cila përfshin objektivat akademike dhe hulumtuese, i udhëheqë veprimet kryesore të saj, i përcakton palët parësore të interesit dhe e ofron kornizën brenda së cilës janë formuluar strategjitë dhe vlerat themelore. Me rastin e përcaktimit të misionit të AKSP-së për vitet e ardhshme si dhe rrugën të cilën duhet ndjekur përmes shtyllave kryesore të saj janë marrë në konsideratë shumë elemente por më kryesore janë: ***Përgjegjësia, Shërbimet e ofruara, Cilësia, Kompetenca, Komuniteti***

Misioni: Ofroj trajnime, arsimim dhe hulumtim me cilësi të lartë në fushën e sigurisë publike për të ndihmuar në ofrimin e ambientit të sigurtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Deklarata e vizionit të AKSP-së e përcakton pozicionin dhe pikëpamjen e Akademisë në të ardhmen, e në të njëjtë kohë duke qenë si kornizë për planifikimin strategjik. Ajo e përcakton drejtimin e organizatës, i cili mund të arrihet përmes formave të veçanta të veprimit. Vizioni i AKSP-së po ashtu pasqyron vlerat e pritura, kompetencat themelore dhe parimet bazë të sjelljes së punëtorëve të saj. Me rastin e përcaktimit të vizionit të AKSP-së për vitet e ardhshme, janë marrë në konsideratë shumë elemente por më kryesore janë: ***Aspekti ligjor, Akreditimet, Përgjegjësia dhe Programi Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025***

Vizioni: Akademia përmes ofrimit të trajnimeve dhe arsimimit me cilësi dhe standarde të ekselencës do të jetë faktor kyç në ngritjen e kapaciteteve të zbatuesve të liqit konformë ndryshimeve dhe sfidave me të cilat përballën.

Misioni i Akademisë është i qartë, ofron shërbime me cilësi të lartë të trajnimit, arsimit, kërkimit dhe zhvillimit në fushën e sigurisë publike.

Vlerat themelore të AKSP-së përshkruajnë bindjet të cilat janë ndarë me të gjitha palët e interesit e akademisë. Ato sigurojnë kornizën në të cilën janë marrë vendimet dhe i vendosin parimet udhëheqëse të cilat i përcaktojnë normat e zbatueshme të sjelljes dhe veprimit të cilat përveq aspektit parimor janë vlera të cilat i ndjen dhe i zbaton personeli i AKSP. AKSP-ja ka përcaktuar këto vlera themelore: ***ndershmërinë, transparencën, përgjegjësinë, diversitetin dhe etikën profesionale.***

Deklarata e misionit, vizionit dhe vlerat themelore janë miratuar me Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm (*shih shtojcen 1*) të përcaktuara në Strategjinë Zhvillimore dhe Planin e Veprimit të AKSP-së 2023-2026 (*shih aneksin 9*) si dhe janë zbërthyer të gjitha elementet e vendosura si misioni, vizioni dhe vlerat (*shih aneksin 9a*) Strategjia Zhvillimore gjithashtu përcakton partnerët e bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe i përshkruan veprimet madhore për AKSP-në, për përmbushjen e misionit dhe vizionit të saj. Po ashtu tashmë janë njoftuar të gjithë akterët me dokumentin sipas planit të komunikimit të strategjisë (*shih aneksin 9c*)

2. KUSH JEMI NE

Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) është institucion me rëndësi të veçantë për Republikën e Kosovës, pasi që është i vetmi institucion publik përgjegjës për ofrimin e të gjitha niveleve të trajnimit dhe arsimit të lartë, zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike për të gjitha institucionet e sigurisë publike në Republikën e Kosovës.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është themeluar në shtator të vitit 1999.

Ky kampus ka ekzistuar që nga vitet e 60-ta, ndërsa deri në vitin 1971, është shfrytëzuar si instituti i trajnimit të ish-Armatës jugosllave. Më pastaj, deri në vitin 1990 shërbeu si shkollë e mesme policore. Pas vitit 1990, ky institucion u rikthye në bazë ushtarake për ushtrinë serbe, deri në vitin 1999.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, ishte e nevojshme krijimi i institucioneve të Kosovës, ku bashkësia ndërkombëtare përmes organizatave të saj ndihmoi Kosovën në shtet ndërtim.

Në shtator të vitit 1999, Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë, së bashku me Misionin e Kombeve të Bashkuara (UNMIK) krijuan Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës, e cila filloi trajnimin e kadetëve të rinj të policisë. Gjatë vitit 2003-2004 kjo shkollë u transformua si institucion kyç për ofrimin e trajnimeve për Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës, Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Në vitin 2006 filloi faza e bartjes së kompetencave nga institucionet ndërkombëtare tek ato vendore. Gjatë këtij viti (2006) Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës i'u ndërrua emri, duke marr kështu emrin Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH).

Më 26 mars 2008 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara shpalli Udhëzimin Administrativ Nr. 2008/3 dhe Rregulloret 2008/17 dhe 2008/18, që ligjërisht e themeloi Qendrën e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) si agjenci ekzekutive e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Qendra (QKSPEZH) ka ofruar trajnime të përbashkëta për të gjitha institucionet e sigurisë publike, duke u fokusuar posaçërisht në trajnimet themelore (bazike), të avancuara, si dhe të menaxhmentit dhe të lidhshmit.

Më pas me hyrjen në fuqi të ligjit për AKSP-në 'Ligji Nr. 04/L-053' më 25 Nëntor 2011 (*shih aneksin 1*) ky institucion mori emrin Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), siç quhet edhe sot.

Akademia është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Është përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive si dhe zhvillimin e kapaciteteve për të gjitha institucionet e sigurisë publike, por pa

u kufizuar vetëm në to: Policia e Kosovës (PK), Shërbimin Korrektues i Kosovës (SHKK), Shërbimin Sprovues i Kosovës (SHSK), Doganat e Kosovës (DK), Agjencinë për Menaxhim Emergjent (AME) dhe Inspektorati Policor të Kosovës (IPK).

Gjatë viteve 2012/2014, në kuadër të projektit të binjakëzimit IPA 2009 “*Përmirësimi i arsimit në sektorët e rendit dhe sigurisë publike*” i financuar nga BE dhe i implementuar nga Finlanda dhe Estonia, AKSP ka hartuar programin studimor Bachelor (BA), i cili i ka plotësuar kërkesat e standardeve më të larta evropiane dhe ndërkombëtare dhe ku të drejtën për të studiuar kanë të gjithë zyrtarët e sigurisë publike në Kosovë. Ofrimi i arsimit të lartë në sigurinë publike, ngritë profesionalizmin, lidërshtipin dhe menaxhimin e kapaciteteve të agjencive përkatëse për të mbështetur krijimin e një sigurie moderne dhe të qëndrueshme në Kosovë.

Vlenë të theksohet se në 2024 e pritët të vazhdojë deri në vitin 2025, AKSP ka hyrë në një fazë reformuese (konsolidues) në fushën e arsimit të lartë sipas kërkesave dhe nevojave të ISP-ve dhe rrethanave të reja të krijuara nga fusha e arsimit të lartë.

Përmes projektit të dytë të binjakëzimit për AKSP-në, projekti IPA 2014 “*Përkrahja e mëtejme e arsimit në Sigurisë Publike në Kosovë*”, 2016 – 2019, financuar nga BE dhe i implementuar nga Finlanda dhe Estonia, AKSP ka zhvilluar strukturën e qëndrueshme për trajnimet profesionale (vokacionale) për të gjitha agjencitë e sigurisë publike në Kosovë. Pra, janë dizajnuar kurrikula të reja profesionale, duke u bazuar në kornizën kombëtare të kualifikimeve respektivisht kornizës evropiane të kualifikimeve dhe të krahasueshme sipas standardeve më të larta evropiane dhe ndërkombëtare.

AKSP ka arritur rezultate dhe suksese të mëdha duke radhitur akreditimet dhe riakreditimet e ndryshme institucionale dhe programe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në nivel të fushëveprimtarisë së trajnimeve dhe arsimit të lartë. Momentalisht në nëntor të vitit 2024, AKSP do t’i nënshtrohet verifikimit të fakteve të mbledhura për procesin e akreditimit institucional nga ekspertët ndërkombëtar nga IADLEST i SHBA-ve.

Akademia po ashtu është shumë aktive dhe angazhohet vazhdimisht në rrjetet e bashkëpunimit ndërkombëtare. AKSP ka krijuar dhe po zhvillon e ngrit vazhdimisht rrjet të mirë të bashkëpunimit me institucionet, asociacionet e mekanizmat tjerë relevantë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të rritur njohuritë dhe aftësitë në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve institucionale dhe profesionale në fushën e sigurisë publike, të zbatuesve të ligjit në Kosovë, përmes trajnimeve, shkëmbimin e përvojave më të mira, etj.

Në këtë kontekst, Akademia ka arritur të ketë një bashkëpunim të ngushtë dhe të qëndrueshëm:

- me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë (brenda dhe jashtë vendit): nga Evropa (Misioni i OSBE-së në Kosovë, Bashkimi Evropian, Komisioni Evropian, Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF),
- dhe ICITAP (partnerë të përhershëm), pastaj nga, INL (Ambasada e SHBA-ve në Kosovë),

- me institucionet respektive nga vendet e BE-së (Estonia, Finlanda, Gjermania, Norvegjia, Polonia), nga vendet e regjionit (Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i zi), nga SHBA (North Eastern University, Utah Valley University, North Carolina Justice Academy),
- me mekanizma dhe rrjete (asociacione) të ndryshme si: CEPOL – Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnim në Zbatimin e Ligjit; AEPC - Asociacionit të Kolegjeve Policore Evropiane; INTERPA - Asociacioni Ndërkombëtar i Akademive Policore; IADLEST - Asociacioni Ndërkombëtar të Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimit të Zbatimit të Ligjit; EFSCA - Asociacioni i Kolegjeve Evropiane të Shërbimit të Zjarrëfikjes; FRANCPOL - Rrjeti Ndërkombëtar Frankofon të Trajnimit Policor

Përderisa AKSP ka arritur të jet përfituese përmes formave, programeve dhe fondeve të ndryshme në nivel ndërkombëtar, si, përmes programeve të BE-së (CEPOL, Erasmus+, TAIEX), dhe të SHBA-ve (Fullbright specialist).

Përshkrimi i vendndodhjes së kampusit të AKSP-së

Akademia e Kosovës për Siguri Publike gjendet në:


Rr. “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Nr. 60, 42000 Vushtrri, Republika e Kosovës.

Kontakti:

info.aksp@rks-gov.net;

+383 (0)28 590 070;

www.aksp-ks.net



AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE
KOSOVSKA AKADEMIJA ZA JAVNU BEZBEDNOST
KOSOVO ACADEMY FOR PUBLIC SAFETY



Programet trajnuese dhe arsimore

Nr.	Programet trajnuese dhe arsimore	Nr i studentëve/ vijueseve
1	Trajnimet Profesionale - Kjo kategori e trajnimeve paraqet procesin e hapave të parë që ndërlidhen me një karrierë apo drejtim specifik të profesionit. Trajnimi profesional fokusohet në aplikimet praktike të aftësive të mësuara dhe në përgjithësi arrin ndërlidhjen e aplikimit të saj në praktikë. Një pjesë e madhe e arsimit në shkollat profesionale është trajnimi praktik.	Numri i kadetëve dhe vijueseve të trajnimeve caktohet bazuar në nevojat e trajnimeve të ISP-ve. AKSP përgatit planin vjetor për trajnime që parashikohet të mbahen në vitin vijues ku përcaktohen të gjitha llojet e trajnimeve dhe numri i pjesëmarrësve sipas ISP.
2	Trajnimet Themelore - Kjo kategori e trajnimit paraqet procesin e marrjes së njohurive bazike në aspektin teorik dhe praktik për zyrtarët përkatës të agjencive të sigurisë publike, të cilat ballafaqohen me detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.	
3	Trajnimet e Avancuara - Kjo kategori e trajnimit ndryshe nga ato themelore, paraqesin procesin e përvetësimit të njohurive në shkallë të avancuar në aspektin teorik dhe praktik për zyrtarët e përkatës të agjencive të sigurisë publike që në fushën e tyre do të jenë në gjendje të punojnë pa mbikëqyrje ose mbikëqyrje të kufizuar.	
4	Trajnimet e Specializuara - Kjo kategori e trajnimit, ndryshe nga ato themelore dhe të avancuara, paraqet procesin e përvetësimit të njohurive në shkallën më të lartë në aspektin teorik dhe praktik për zyrtarët përkatës të agjencive të sigurisë publike, të cilët në fushën e tyre do të jenë në gjendje të punojnë në mënyrë të pavarur duke ofruar këshilla dhe opinione profesionale në Fushën e sigurisë publike.	
5	Trajnimet për Instruktor/trajner -Kjo kategori e trajnimit, paraqet një fushë të përgatitjes së kuadrove të reja të instruktorëve /trajnerëve në fushën e trajnimeve në aspektin teorik dhe praktik për zyrtarët përkatës të agjencive të sigurisë publike, të cilët do të jenë në gjendje të punojnë në cilësinë e instruktorit/trajnerit.	
6	Programi Studimor Bachelor në Siguri Publike Programi BA nësiguri publike, është program studimi nga fusha e sigurisë publike e cila në aspektin përmbajtësor ndahet në atë teorik të fushave të specializuara dhe pjesës praktike-internshipit e cila është pjesa kryesore e programit. Pjesa teorike dhe praktike e studimeve janë të integruar, ndërsa për çdo vit të studimit është e planifikuar edhe periudha e punës praktike-internshipi. I diplomuar do jetë i aftë të bëhet specialist, profesionist apo menaxher në Siguri Publike. Nga semestri i trete, studentët do të zgjedhin njërin nga drejtimet si vijon në fushën: • <i>Policor dhe Inspektorat,</i> • <i>Doganor,</i> • <i>Korrektues dhe Sprovues,</i> • <i>Menaxhimi Emergjent.</i>	Studentët e Fakultetit të Sigurisë Publike FSP janë zyrtar të punësuar në Institucionet e Sigurisë Publike.

Trajnimet Profesionale - janë trajnime të fushës së profesionit dhe janë trajnime mandatore për të qenë pjesë e ISP-ve. Këto trajnime janë të validuara nga KD i AKK me standard të profesionit të njohur nga KAAPRR dhe AKK në përputhje të plotë me KKK dhe ofrohen nga AKSP si IAAP i akredituar. Listimi i trajnimeve profesionale si në vijim:

- **Kualifikimi Zyrtar Policor** - Akademia në bashkëpunim me PK-në, ka përgatitur listën e personelit për ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit (*shih aneksin 15*). Ky kualifikim përmban gjithsej 1440 orë duke përfshirë edhe modulet zgjedhore, prej tyre 1138 orë janë kontakt dhe mbikëqyrje, ndërsa 302 orë janë vetë studim. Me qëllim të mbulimit të këtij kualifikimi, AKSP në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në AKSP, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ka përgatitur listën e personelit trajnues të cilët do të angazhohen në kuadër të këtij kualifikimi.

Numri i përgjithshëm i personelit trajnues është 92. CV-të janë të bashkangjitura (*shih aneksin 16*)

Personeli i angazhuar në ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit është kompetent meqë pjesa dërmuese e tyre kanë të përfunduar shkollimin e lartë dhe kanë përvojën adekuate në module të caktuara në kuadër të këtij kualifikimi. Personelit trajnues do të do të angazhohet me rastin e fillimit të trajnimit (*procedura është përcaktuar me vendim nr.3/18 të Bordit të AKSP-se*). Varësisht nga kohëzgjatja e trajnimit personeli trajnues do të angazhohet me kohe të përkohshme dhe kohe të përhershme (*shih aneksin 8 dhe 9*).

Stafi trajnues i PK-së do të angazhohet në programet trajnuese në përputhje me Ligjin e Akademise (*shih aneksin 2*).

Dokumentet e kërkuara t'i bashkëngjiten aplikacionit.

aneksin 15- Lista e stafit mësimdhënës për kualifikimin Zyrtar Policor

aneksin 16- CV-të e stafit mësimdhënës për kualifikimin Zyrtar Policor

aneksin 17a- Lista e Eksperteve

- **Kualifikimi Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës** - Akademia në bashkëpunim me IPK-në, ka përgatitur listën e personelit për ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit (*shih aneksin 15a*). Ky kualifikim përmban gjithsej 1660 orë duke përfshirë edhe modulet zgjedhore. Të gjitha modulet mbulohen me staf mësimdhënës nga AKSP-ja së bashku me IPK-në ashtu siç parashihet edhe në Marrëveshjen e Mirëkuptimit (*shih aneksin 13a*).

Me qëllim të mbulimit të këtij kualifikimi, Akademia në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Akademi, në bashkëpunim me Inspektoratin Policor të Kosovës, ka përgatitur listën e personelit trajnues të cilët do të angazhohen në kuadër të këtij kualifikimi. Sipas vendimit të Bordit të Akademisë për Rishikimin e Trajnimeve Profesionale nga Institucionet e Sigurisë Publike (*shih aneksin*

2a7). Personeli i propozuar është i kualifikuar, mbështetur në shkollimin dhe përvojën e tyre për mësimdhënie adekuate për module të caktuara në kuadër të këtij kualifikimi. Angazhimi i personelit do të behet sipas planit institucional për fillimin e trajnimit. Personelit trajnues do të angazhohet në mësimdhënie ashtu siç parashihet edhe në Marrëveshjen e Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë dhe IPK-së rastin e fillimit të trajnimit (procedura është përcaktuar me vendim nr.8/18 të Bordit të Akademisë). *(shih aneksin 13a)*

Rishikimi i Trajnimit Profesional është bërë nga grupi profesional i përbërë nga Akademia dhe IPK-ja me vendim të Bordit të Akademisë *(aneksi 2a)*

Dokumentet e kërkuara t'i bashkëngjiten aplikacionit.

aneksin 13a: Marrëveshja e Mirëkuptimit ndërmjet AKSP-IPK

aneksin 2a- Rishikimi i Trajnimeve Profesionale nga Institucionet e Sigurisë Publike

aneksin 15a- Lista e stafit mësimdhënës për kualifikimin inspektor, e aprovuar nga Bordi i AKSP-së

aneksin 16a - CV-të e stafit mësimdhënës për kualifikimin inspektor

- **Kualifikimi Zyrtar Doganor** - Akademia në bashkëpunim me DK-në, ka përgatitur listën e personelit për ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit *(shih aneksin 15d)*. Ky kualifikim përmban gjithsej 1100 orë duke përfshirë edhe modulet zgjedhore. Të gjitha modulet mbulohen stafi trajnues nga Akademia dhe DK sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë dhe DK-së, gjithashtu në rastin se kadetët përzgjedhin Modulën Arrest dhe Ndalim stafi trajnues nga *(shih aneksin 2)*, Policia e Kosovës do të asistojë në mbajtjen e këtij moduli. Me qëllim të mbulimit të këtij kualifikimi, Akademia në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Akademi, dhe në bashkëpunim me Doganën e Kosovës ashtu siç parashihet edhe në Marrëveshjen e Mirëkuptimit ndërmejt Akademisë dhe DK-së *(shih aneksin 13d)* si dhe vendimin e Bordit të Akademisë për Rishikimin e Trajnimeve Profesionale *(shih aneksin 2a)*, ka përgatitur listën e personelit trajnues të cilët do të angazhohen në kuadër të këtij kualifikimi. Numri i personelit trajnues është i dëshmuar përmes CV-ve *(shih aneksin 16d)*. Personeli i angazhuar në ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit është kompetent sa i përket sa i përket shkollimit dhe përvojës adekuate për mësimdhënie për module të caktuara në kuadër të këtij kualifikimi.

Personeli trajnues do të angazhohet me rastin e fillimit të trajnimit ashtu siç parashihet në Marrëveshjen e Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë dhe DK-së *(shih aneksin 13d)*

Rishikimi i Trajnimit Profesional është bërë nga grupi profesional i përbërë nga Akademia dhe DK-ja me vendim të Bordit të Akademisë *(shih aneksin 2a)*

Dokumentet e kërkuara t'i bashkëngjiten aplikacionit.

aneksin 13d- Marrëveshja e Mirëkuptimit ndërmjet AKSP-së dhe DK-së

aneksin 2a- Rishikimi i Trajnimeve Profesionale nga Institucionet e Sigurisë Publike

aneksin 15d- Lista e stafit mësimdhënës për kualifikimin Zyrtar doganor

aneksin 16d- CV-të e stafit mësimdhënës për kualifikimin Zyrtar doganor

- **Kualifikimi Zjarrfikës** - Akademia në bashkëpunim me AME-në, ka përgatitur listën e personelit për ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit “Zjarrfikës”. Ky kualifikim përmban gjithsej 800 orë duke përfshirë edhe modulet zgjedhore, Të gjitha modulet do të mbulohen me staf trajnues ashtu siç parashihet në Marrëveshjen e Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë dhe SHKK-së (shih *aneksin 13e*). Numri i personelit trajnues i dëshmuar me CV-të (shih *aneksin 16e*). Personeli i angazhuar në ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit është kompetent, mbështetur në shkollimin dhe përvojën adekuate për mësimdhënie për module të caktuara në kuadër të këtij kualifikimi dhe angazhimi i tyre do të bëhet konform Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë dhe AME-së (*aneksi 13e*)

Rishikimi i Trajnimit Profesional është bërë nga grupi profesional i përbërë nga Akademia dhe DK-ja me vendim të Bordit të Akademisë (shih *aneksin 2a*)

Dokumentet e kërkuara t'i bashkëngjiten aplikacionit.

aneksin 13e Marrëveshja e Mirëkuptimit ndërmjet AKSP-së dhe AME-së

aneksin 2a- Rishikimi i Trajnimeve Profesionale nga Institucionet e Sigurisë Publike

aneksin 15e- Lista e stafit mësimdhënës për kualifikimin Zjarrfikës, e aprovuar nga Bordi i AKSP-së

aneksin 16e- CV-të e stafit mësimdhënës për kualifikimin Zjarrfikës

- **Kualifikimi Zyrtar Korrektues** - Akademia në bashkëpunim me SHKK-në, ka përgatitur listën e personelit për ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit (shih *aneksin 15b*). Ky kualifikim përmban gjithsej 1080 orë duke përfshirë edhe modulet zgjedhore, Të gjitha modulet mbulohen me mësimdhënës ashtu siç parashihet në Marrëveshjen e Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë dhe SHKK-së.

Me qëllim të mbulimit të këtij kualifikimi, Akademia në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Akademi, në bashkëpunim me Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka përgatitur listën e personelit trajnues të cilët do të angazhohen në kuadër të këtij kualifikimi. Numri i personelit trajnues është i dëshmuar me CV-të e bashkangjitura (shih *aneksin 16b*)

Personeli i angazhuar në ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit është kompetent mbështetur në shkollimin dhe përvojë adekuate për mësimdhënie për module të caktuara në kuadër të këtij kualifikimi dhe angazhimi i tyre do të bëhet konform Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë dhe SHKK-së (*shih aneksin 13b*)

Rishikimi i Trajnimit Profesional është bërë nga grupi profesional i përbërë nga Akademia dhe SHKK-ja me vendim të Bordit të Akademisë (*aneksi 2a*)

Dokumentet e kërkuara t'i bashkëngjiten aplikacionit.

aneksin 13b- Marrëveshja e mirëkuptimit ndërmjet akademisë dhe dk-së

aneksin 2a- Rishikimi i trajnimeve profesionale nga institucionet e sigurisë publike

aneksin 15b- Lista e stafit mësimdhënës për kualifikimin zyrtar korrektues,

aneksin 16b- CV-të e stafit mësimdhënës për kualifikimin zyrtar korrektues

- **Kualifikimi Zyrtar Sprovues**- Akademia në bashkëpunim me SHSK-në, ka përgatitur listën e personelit për ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit (*shih aneksin 15c*). Ky kualifikim përmban gjithsej 660 orë duke përfshirë edhe modulet zgjedhore, Të gjitha modulet do të mbulohen me stafin trajnues, ashtu siç parashihet në Marrëveshjen e Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë dhe SHSK-së (*shih aneksin 13c*). Me qëllim të mbulimit të këtij kualifikimi, Akademia në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Akademi, në bashkëpunim me Shërbimin Sprovues të Kosovës, ka përgatitur listën e personelit trajnues të cilët do të angazhohen në kuadër të këtij kualifikimi. Numri i personelit trajnues është i dëshmuar me CV-të e bashkangjitura (*shih aneksin 16c*). Personeli i angazhuar në ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit është kompetent i mbështetur në shkollimin dhe përvojën adekuate për mësimdhënie për module të caktuara në kuadër të këtij kualifikimi. Dhe angazhimi i tyre do të bëhet konform Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë dhe SHSK-së. (*shih aneksin 13c*)

Rishikimi i Trajnimit Profesional është bërë nga grupi profesional i përbërë nga Akademia dhe SHSK-ja me vendim të Bordit të Akademisë (*shih aneksin 2a*)

Dokumentet e kërkuara t'i bashkëngjiten aplikacionit.

aneksin 13c-Marrëveshja e mirëkuptimit ndërmjet akademisë dhe shsk-së

aneksin 2a- Rishikimi i trajnimeve profesionale nga institucionet e sigurisë publike

aneksin 15c- Lista e stafit mësimdhënës për kualifikimin zyrtar sprovues,

aneksin 16c- CV-të e stafit mësimdhënës për kualifikimin zyrtar sprovues,

Tabela e kategorive te trajnimeve qe ofrohen ne Akademi per ISP

Institucionet e sigurise publike - ISP	Kategoritë e trajnimeve në Akademi				
	Trajnimet Profesionale	Trajnimet Bazike	Trajnimet e Avansuara	Trajnimet e Specializuara	Trajnimet për instruktor
Policia e Kosovës	1	32	37	11	9
Agjencioni për Menaxhim të Emergjencave	1	20	1	1	1
Dogana e Kosovës	1	12	8	5	/
Departamenti për Siguri në Bashkësi-MPB	/	1	/	/	/
Shërbimi Korrektues i Kosovës	1	4	2	/	1
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	/	7	1	/	/
Inspektoriati Policor i Kosoves	1	/	/	/	/
Sherbimi sprovues i Kosovës	1	/	/	/	/
Agjencioni për Forenzikë i Kosovës	/	/	/	2	/
Totali i trajnimeve sipas kategorive	6	76	49	19	11
Totali i pergjithshem i trajnimeve	161				

4.CILAT JANË KAPACITETET TONA

Infrastruktura fizike / Ndërtesat

Akademia për zhvillimin dhe realizimin e programit profesional për Arsim Aftësim Profesional, Programit Studimor Bachelor në Siguri Publike dhe realizimin e misionit të saj institucional posedon, hapësira, salla, kabinete dhe amfiteatro si vijon:

4.1 Tabela / Hapësirat

Hapësirat	Numër	Sipërfaqja në m ²
Salla të mësimi	20	1522.63 m ²
Laboratorët	2	140 m ²
Kabinete	10	150 m ²
Amfiteatro	1	850 m ²
Salla Sportive	2	1222.68 m ²
Konvikte për akomodim	3	7805 m ²
Ndërtesa e FSP	1	7000 m ²

Në vazhdim një përshkrim i shkurtë për të gjitha objektet të cilat i posedon Akademi në kuadër të kampusit të saj

Ndërtesa kryesore

Ndërtesa kryesore është objekti kryesor dhe gjithsej ka 20 klasë mësimi të cilat janë të pajisura me projektorë, kompjuterë dhe kanë mbulim të plotë me Wi-fi. Sipërfaqja e përgjithshme e klasave në këtë objekt është 1522.63 kurse sipërfaqja e përgjithshme është 4953.07 m² që shihet se mesatarja e sipërfaqes së klasave është 76.13 m². Çdo klasë, në këtë objekt, ka nga 15 tavolina dhe 30 karrige, që do të thotë se në një klasë mund t'i ndjekin mësimet 30 kadet /student/vijues të trajnimeve, pra ndërtesa kryesore ka kapacitet për 600 kadet /student vijues të Programit Bachelor/vijues të trajnimeve të ndryshme, të ndjekin njëkohësisht aktivitetet e tyre. Klasat janë të pajisura me projektor po ashtu, nëntë prej tyre janë të pajisura me smart- board kurse të gjitha klasat janë të pajisura me tabelë të bardhë. Pjesë e ndërtesës kryesore po ashtu është edhe një numër i konsiderueshëm i zyrave të cilat shërbejnë për nëpunësit e administratës të cilët veprojnë në kuadër të Akademisë.

Konvikti I

Akademia ofron akomodim për të gjithë kadetët /studentët vijues të Programit Bachelor si dhe për vijuesit e trajnimeve të ndryshme në kuadër të Akademisë, të cilët dëshirojnë të banojnë gjatë kohës së ndjekjes së aktiviteteve të tyre përkatëse. Konvikti i ka sipërfaqe prej 2706.35 m² dhe shërben për akomodimin e studentëve meshkuj, kapaciteti i banimit në këtë objekt është 600 vetë.

Konvikti II

Konvikti II ofron akomodim për femrat, instruktorët të cilët dëshirojnë të banojnë gjatë kohës së ndjekjes së aktiviteteve të tyre përkatëse i cili ka sipërfaqe prej 1293.07 m².

Konvikti III i Kategorisë së Lartë në AKSP

Konvikti i kategorisë së Lartë gjendet në kuadër të kampusit të Akademisë dhe është i dedikuar për banim. Sipërfaqja e përgjithshme e objektit gjithsejtë 3,803.95 m²

Salla për trajnime simulative me arme zjarri FATS

Salla për trajnime simulative me arme zjarri FATS-i përfshin 144 m² dhe posedon sistemin më të avancuar të pajisjes simulative i cili është i vendosur në sallën kryesore.

Palestra sportive

Objekti i palestrës sportive ka sipërfaqe prej 1222.68 m² e cila mundëson zhvillimin e aktiviteteve sportive për të gjithë kadetët /studentët vijues të Programit Bachelor / vijuesit e trajnimeve të ndryshme dhe njeherit edhe për mbajtjen e testeve fizike për kadetët e rinjë, po ashtu në këtë objekt gjendet edhe salla e gjimnastikës me pajisje fitnesi.

Mensa

Objekti i mensës përfshin sipërfaqe prej 548.75 m² dhe shërben për të ofruar racione ushqimi për kadetët /studentët vijues të Programit Bachelor / vijuesit e trajnimeve të ndryshme, kapaciteti i së cilës përfshin 300 persona. Aktualisht Akademia ka në proces ndërtimin e menzës së re e cila pritet të finalizohet përgjatë vitit 2023-2024 me këto specifika si në vijim:

- 2007 m² sipërfaqe,
- 400 persona njëkohësisht të shërbehen.

Ambulanca

Objekti i ambulancës ka sipërfaqe prej 131.8 m² pra ka hapësirë të mjaftueshme për ofrimin e trajtimit primar shëndetësor për të gjithë vijuesit kadetët /studentët vijues të Programit Bachelor / vijuesit e trajnimeve të ndryshme në Akademi.

Logjistika

Objekti i logjistikës ka sipërfaqe 1111 m² e cila përfshin depot për sistemimin e materialeve të ndryshme të cilat përdoren për shërbime të ndryshme në Akademi.

Ngrohtorja

Përmes objektit të ngrohjes realizohet ngrohja qendrore për të gjitha objektet e Akademisë. Objekti i ngrohjes ka / sipërfaqe 168.16 m² dhe është i pajisur me sistemin e kalldajave që shërbejnë për këtë proces të ngrohjes.

Arkiva

Objektin i arkivës ka sipërfaqe prej 78.84 m² dhe është i pajisur me infrastrukturën përkatëse përmes së cilës arkivohen dhe ruhen të gjitha dokumentet në nivel të Akademisë.

Ndërtesa (salla) nr. 14

Ky objekt ka sipërfaqe prej 684.85 m² përdoret për organizimin e ligjëratave për studentet e Fakultetit të Sigurisë Publike-FSP dhe për trajnime tjera të ndryshme.

Qendra mësimore “Steve Bennet”

Qendra Steve Bennet ka sipërfaqe prej 1753.39 m² në të cilën gjenden dy salla të cilat shërbejnë për takime të Menaxhmentit, konferenca të ndryshme, takime të Bordit të Akademisë dhe janë të pajisura me të gjithë inventarin e nevojshëm bashkëkohor për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Depoja

Objekti i depos ka sipërfaqe prej 1418.87 m² dhe një infrastrukturë të mjaftueshme që përdoret për deponimin e mallrave të ndryshme që shërbejnë për nevojat e Akademisë.

Ndërtesa e kopshtarisë

Duke u bazuar në faktin se kampusi i Akademisë është një hapësirë e gjerë kemi ekipin i cili mirëmban hapësirat dhe ky objekt shërben për nevojat e këtij ekipi si dhe ruajtjen e mjeteve të punës. Ky objekt ka sipërfaqe prej 29.50 m².

Ndërtesa Administrative

Në objektin e Administratës janë të vendosur Menaxhmenti i Akademisë dhe nëpunës tjerë të cilët merren me mbarrëvajtjen e punëve të Akademisë. Ky objekt ka sipërfaqe prej 621.2 m² dhe posedon infrastrukturën bashkëkohore të nevojshme e cila ju ofron nëpunësve një komoditet dhe mirëqenie gjatë orarit të punës.

Ndërtesa e poligonit të mbyllur

Ndërtesa e poligonit të mbyllur, për trajnim me armë të shkurtra me sipërfaqe prej 400 m² shfrytëzohet nga të gjithë vijuesit te trajnimeve të cilët obligohen të vijnë trajnimin me arme zjarri. Ky objekt ka të inkuorporuar një sistem kontrolli të teknologjisë së fundit.

Ndërtesa e Sigurimit

Objekti i Sigurimit ka sipërfaqe prej 108.7 m² shfrytëzohet nga zyrtaret e sigurimit të cilët janë përgjegjës për ruajtjen e hapësirave të Akademisë. Ky objekt është i pajisur me sistemin e kamerave në të gjithë hapësirat e Akademisë dhe monitorohet 24/7.

Stacioni i pompave

Në objektin e sistemit të pompave janë të montuara pompat për qarkullimin e ujit teknik në të gjitha objektet dhe ka sipërfaqe prej 20 m²

Lavanderia

Spektori i Logjistikes ka objektin e lavanderisë me sipërfaqe prej 288.09 m² ,në të cilin gjendet ekipi i cili kujdeset për pastrimin e uniformave të kadetëve dhe gjerave të tjera, gjë e cila realizohet përmes makinave të lavanderise të cilat janë te vendosura ne objektin përkatës.

Ndërtesa e Fakultetit të Sigurisë Publike

Spektori i Logjistikes ka ne përfundimin e sipër edhe ndërtesën e Fakultetit te Sigurisë Publike me sipërfaqe prej 7000 m² . Ne këtë objekt do vendoset administrata e FSP me stafin akademik dhe student.

Master Plani - Akademia ka të hartuar Master Planin për Kompleksin e saj ku është përcaktuar korniza për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e objekteve të kompleksit të Akademisë. Master plani i siguron institucionit një bazë për zhvillim të këtij kompleksi, me një infrastrukturë bashkëkohore dhe me një plan i cili do të mundësojë investime të mëtutjeshme në kompleks.(shih aneksin 3)

Burimet njerëzore

Bazuar ne Ligjin Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (*shih aneksin1*), personeli i Akademise ndahet në:

- *personel menaxhues;*
- *personel mbështetës;*
- *personel trajnues dhe mësimdhënës;*

- Numri i vendeve të punës të konfirmuara në buxhet është gjithsej **njëqind e pesëdhjetë e gjashtë(156).**
- Numri aktual i të punësuarve është **njëqind e njëzet e gjashtë (126).**

Numri aktual i të punësuarve sipas strukturës kualifikuese, etnike dhe gjinore e pasqyruar në tabelë:

Totali i stafit te AKSP	Përbërja strukturore e stafit të Akademisë																
	Ngritja profesionale				Përbërja etnike									Gjinore		Aftësi te kufizuar	
	Fakultet	Shkollim i lartë	Shkollim i mesëm	shkollim fillor	Shqiptar	Serbë	Boshnjak	Turk	Goran	Ashkali	Egjiptian	Romë	Etni tjera	Mashkull	Femër	Mashkull	Femër
137	71	1	64	0	121	3	0	2	0	0	0	0	0	81	45	2	0

Tabela 4.2 Numri i të punësuarve, kualifikimet, përkatësia etnike, struktura gjinore në Akademi (shih aneksin 4)

Trajnimet e ofruara brenda vendit për stafin e Akademisë

nr	Emertimi i trajnimit	organizuar nga	data	vendi	zyrtar te trajnuar
1	Trajnimi per Trajner (TOT) per krijimin e permbajtjes dixhitale	IKAP	10-11.05.2023	Prishtinë	1
2	Trajnimi Ngacmimet Seksuale ne vendet e Punes	BDO	11-12.05.2023	Prishtinë	18
3	Trados Studio 2022-Level 1 Training	THK	05.05.2023	Prishtinë	18
4	Moduli i Menaxhimit të Parasë së Gatshme	ATRC	13.06.2023	Vushtri	1
5	Trajnimi Elementet Baze te Menaxhimit	TBM	19-23.06.2023	Vushtri	1
6	Trajnimi Konflikti i Interesit	IKAP	12-13.07.2023	Prishtinë	15
7	Trajnimi Etika në vendin e Punës	AKSP	07-11.08.2023	Vushtri	16

Trajnimet e ofruara jashtë vendit për stafin e Akademisë

nr	Emertimi i trajnimit	organizuar nga	data	vendi	zyrtar te trajnuar
1	Cikli i proceseve te prokurimit publik ne realizimin e Buxhetit te Planifikuar perfshire fazat kryesore	FLSA	01-04.04.2024	Shqiperi	2
2	Quality Assurance, Knowledge Exschange and Training	NORTH CAROLINA JSUTICE ACADEMY	28-31.05.2024	USA	3
3	CEPOL Young Researchers Network 2024	Budapest	03-04.06.2024	Hungary	1
4	Europian Fire Services Colleges Association	University Warsaw	10-13.06.2024	Poloni	3

Mjetet e Kualifikimit për Zyrtar Policor

Akademia posedon të gjitha pajisjet që janë të nevojshme për ofrimin gjegjësisht konkretizimin e kurikulës dhe moduleve të saj bazuar në metodat më moderne për ligjërime siç janë: Klasa, Projektor, Kompjuter, Laborator, Poligone, sallat e ushtrimeve, Simulator për gjuajtje me armë, Hapësira për ndihmën e parë etj.

Mirëpo Akademia me qëllim të implementimit të Kurikulës përmes vendimit Nr. 3/18 të Bordit të Akademisë ka arritur bashkëpunimin me PK-në ku të dyja Institucionet janë dakorduar që ta përkrahin njëra –tjetrën me resurset e nevojshme (*aneksi 14-lista e pajisjeve*) për implementimin e kurrikulës.

Lista e Pajisjeve kryesore për realizimin e Kurikulës së PK-së	
Pajisjet nga Akademia	Pajisjet nga PK-ja
• Pajisjet e klasës • Projektori • Flipchart • Markera • Tabela e bardhë • Uniforma e kadetit • Klasa me kompjuter • Poligoni i qitjes i mbyllur dhe i hapur, • armët (pistoleta Glock 19) për trajnim, • municion, • Poligoni i vozitjes • uniforma, rripi zyrtar, jelek anti plumb, bateri, mbrojtëse veshi, syze mbrojtëse, • Laboratori i Forenzikës • Automjeti për trajnimet gjegjëse nga fusha e trafikut • Qyteza simulative • Dhoma simulative • Pajisja për simulim me arme zjarri FATS-it • Sallat sportive (me pajisjet përcjellëse)	• Hapësirat e PK-së për kryerjen e praktikës profesionale • Pajisje të Policisë së Kosovës si në vijim: - prangat, - shufra, - jeleku i sigurisë, - pajisje për audio-video - elektrik dore, - arma zyrtare, - formulari i raportit fillestar, - manuali, - mostra (regjistra) të dokumenteve - Veturat e Policisë, etj.

Mjetet e Kualifikimit për Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës

Akademia posedon të gjitha pajisjet që janë te nevojshme për ofrimin gjegjësisht konkretizimin e kurikulës dhe moduleve të saj bazuar ne metodat me moderne për ligjërime siç janë: Klasa, Projektor, Kompjuter, Laborator, Poligone, sallat e ushtrimeve, Simulator për gjuajte me armë, Hapësira për ndihmën e parë etj. Mirëpo Akademia me qëllim të implementimit të Kurikulës përmes vendimit të Bordit të Akademisë (shih aneksin 13a) ka arrite bashkëpunimin me IPK-në ku të dyja Institucionet janë dakorduar që ta përkrahin njëra –tjetrën me resurset e nevojshme (aneksi 14a-lista e pajisjeve) për implementimin e kurikulës.

Gjithashtu me Marrveshje Mirëkuptimi ndërmjet AKSP-së dhe IPK-së në **nenin 7 Bashkëpunimi i ndërsjellët në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të institucioneve të Sigurisë** pika 5 ku citoj “AKSP dhe IPK do të mbështetin njëra tjetrën me asetet/pajisjet që kërkohen varësisht nga modulet e kurrikulës së trajnimit profesional apo trajnimeve tjera, Asetet/pajisjet e IPK-së do të shfrytëzohen vetëm gjatë zbatimit të trajnimit profesional dhe trajnimeve tjera”

Lista e Pajisjeve kryesore për realizimin e Kurikulës së IPK-së	
Pajisjet nga Akademia	Pajisjet nga IPK-ja
• Pajisjet e klasës • Projektori • Flipchart • Markera • Tabela e bardhë • Uniforma e kadetit • Klasa me kompjuter • Poligoni i qitjes, • armët (pistoleta Glock 19) për trajnim, • municion, • Poligoni i vozitjes • uniforma, rripi zyrtar, jelek anti plumb, bateri, mbrojtëse veshi, syze mbrojtëse, etj • Pajisja për simulim me arme zjarri FATS-it • Qyteza simulative • Dhoma simulative • Sallat sportive (me pajisjet përcjellëse) • Salla e kompjuterëve • Pajisje për kontrolle të ndryshme (dorëza, maskë, dara,	• Hapësirat e IPK-së për kryerjen e praktikës profesionale (INTERSHIPIN) • Pajisje të Inspektoratit Policor si në vijim: - prangat, - shufra, - jeleku i sigurisë, - pajisje për audio-video - elektrik dore, - arma zyrtare, - formulari i raportit fillestar, - manuali, - vetura e inspektoratit policor, - mostra (regjistra) të dokumenteve - Veturat e Inspektoratit Policor, etj.

kaçavida, pajser, thikë-skalper, llapmë- bateri, reflektor, kamere special, pajisje e vogël dhe e mesme për detektimin e radioaktivitetit, pasqyra, pajisje për detektimin e dendësisë, çelësa të ndryshëm për hapjen e mjeteve të ndryshme, metri, ngjitësi, kalkulatori, çekani, shkallët

- Poligoni i vozitjes etj.

Mjetet e Kualifikimit për Zjarrfikës

Akademia posedon të gjitha pajisjet që janë te nevojshme për ofrimin gjegjësisht konkretizimin e kurikulës dhe moduleve të saj bazuar ne metodat me moderne për ligjërime siç janë: Klasa, Projektor, Kompjuter, Laborator, Poligone, sallat e ushtrimeve, Simulator për gjuajte me armë, Hapësira për ndihmën e parë etj.

Mirëpo Akademia me qëllim të implementimit të Kurikulës përmes vendimit të Bordit të Akademisë (*shih aneksin 13e*) ka arrite bashkëpunimin me AME-në ku të dyja Institucionet janë dakorduar që ta përkrahin njëra –tjetrën me resurset e nevojshme (*aneksi 14e –lista e pajisjeve*). Gjithashtu me Marrveshje Mirëkuptimi ndërmjet AKSP-së dhe AME-së në nenin 7 Bashkëpunimi i ndërsjellët në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të institucioneve të Sigurisë pika 5 ku citoj “AKSP dhe AME do të mbështetin njëra tjetrën me asetet/pajisjet që kërkohen varësisht nga modulet e kurrikulës së trajnimit profesional apo trajnimeve tjera, Asetet/pajisjet e AME-së do të shfrytëzohen vetëm gjatë zbatimit të trajnimit profesional dhe trajnimeve tjera” pajisjet e për implementimin e kurikulës si vijon:

Lista e Pajisjeve kryesore për realizimin e Kurrikulës së AME-së	
Pajisjet nga Akademia	Pajisjet nga AME-ja
☐ Pajisjet e klasës ☐ Projektori ☐ Flipchart ☐ Markera ☐ Tabela e bardhë ☐ Uniforma e kadetit ☐ Klasa me kompjuter ☐ Qelia e burgut (AKSP) për luajtjen e roleve ☐ Poligoni i vozitjes, ☐ armët (pistoleta Glock 19), ☐ municion, ☐ uniforma, rripi zyrtar, jelek anti plumb, bateri, ☐ mbrojtëse veshi, syze mbrojtëse, ☐ ambulanca ☐ Qyteza simulative ☐ Dhoma simulative ☐ Sallat sportive (me pajisjet përcjellëse)	☐ Hapësirat e AME-së për kryerjen e praktikës profesionale ☐ Poligoni ☐ Uniforma e punës e zjarrfikësit..... 25 kompl ☐ Pajisjet zjarrfikëse (pajisjet e kamionit të zjarr fikjes) • Pajisjet Personale Mbrojtëse të Zjarrfikësit • Kamioni për zjarr fikje (plotësisht i pajisur sipas dokumentit Autocisterna për zjarr fikje, Shkallët automobilistike për zjarr fikje dhe shpëtim (shkallëhidraulike) Aparatet e frymëmarrjes Fikset e zjarrit Pajisje hidraulike Pajisje pneumatike) • Rollis • Pajisjet për ndihmë të parë: (Çanta e ndihmës së parë për reagim emergjent komplet me pajisje Barela për bartje, Barela zhiletë, Dysheku me vakum, Pajisja përnxjerrjen e viktimës • Pajisjet për komunikim dhe orientim (GPS,Radiolidhje dore, Radiolidhje mobile) etj.

Mjetet e Kualifikimit për Zyrtar Korrektues

Akademia posedon të gjitha pajisjet që janë te nevojshme për ofrimin gjegjësisht konkretizimin e kurikulës dhe moduleve të saj bazuar ne metodat me moderne për ligjërime siç janë: Klasa, Projektor, Kompjuter, Laborator, Poligone, sallat e ushtrimeve, Simulator për gjuajte me armë, Hapësira për ndihmën e parë etj.

Mirëpo Akademia me qëllim të implementimit të Kurikulës përmes vendimit të Bordit të Akademisë (*shih aneksin 13b*) ka arritë bashkëpunimin me SHKK-në ku të dyja Institucionet janë dakorduar që ta përkrahin njëra –tjetrën me resurset e nevojshme (*aneksi 14b –lista e pajisjeve*) për implementimin e kurikulës. Gjithashtu me Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet AKSP-së dhe SHKK-së në **nenin 7** Bashkëpunimi i ndërsjellët në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të institucioneve të Sigurisë pika 5 ku citoj “AKSP dhe SHKK do të mbështetin njëra tjetrën me asetet/pajisjet që kërkohen varësisht nga modulet e kurrikulës së trajnimit profesional apo trajnimeve tjera, Asetet/pajisjet e SHKK-së do të shfrytëzohen vetëm gjatë zbatimit të trajnimit profesional dhe trajnimeve tjera”

Lista e Pajisjeve kryesore për realizimin e Kurikulës së SHKK-së	
Pajisjet nga Akademia	Pajisjet nga SHKK-ja
☐ Pajisjet e klasës ☐ Projektori ☐ Flipchart ☐ Markera ☐ Tabela e bardhë ☐ Uniforma e kadetit ☐ Klasa me kompjuter ☐ Qelia e burgut (AKSP) për luajtjen e roleve ☐ Poligoni i qitjes, ☐ armët (pistoleta Glock 19), ☐ municion, ☐ uniforma, rripi zyrtar, jelek anti plumb, bateri, mbrojtëse veshi, syze mbrojtëse, ☐ Pajisja për simulim me arme zjarri FATS-it	• Hapësirat e SHKK-së për kryerjen e praktikës profesionale (INTERSHIPIN) • Pajisjet e rregullta të punës së zyrtarit korrektues (prangat për duar, shufra, spreji, radiot) • Qelia e burgut për trajnim • Ndërtesa e njësitit për intervenim në Dubravë • Pajisjet për ndihmë të parë (manekini i ndihmës së parë, maskë xhepi, çanta e ndihmës së parë) • Qendra trajnuese në Burgun e Dubravës (njësi për intervenim) • Uniforma • Çelësat e nevojshëm • Radio lidhje etj.

Mjetet e Kualifikimit për Zyrtar Sprovues

Akademia posedon të gjitha pajisjet që janë te nevojshme për ofrimin gjegjësisht konkretizimin e kurikulës dhe moduleve të saj bazuar në metodat me moderne për ligjërime siç janë: Klasa, Projektor, Kompjuter, Poligone, sallat e ushtrimeve, Hapësira për ndihmën e parë etj.

Mirëpo Akademia me qëllim të implementimit të Kurrikulës përmes vendimit të Bordit të Akademisë (*shih aneksin 13c*) ka arritur bashkëpunimin me SHSK-në ku të dyja Institucionet janë dakorduar që ta përkrahin njëra –tjetrën me resurset e nevojshme (aneksi 14c –lista e pajisjeve pajisje) për implementimin e kurikulës. Gjithashtu me Marrveshje Mirëkuptimi ndërmjet AKSP-së dhe SHSK-së në nenin 7 Bashkëpunimi i ndërsjellët në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të institucioneve të Sigurisë pika 5 ku citoj “*AKSP dhe SHSK do të mbështetnin njëra tjetrën me asetet/pajisjet që kërkohen varësisht nga modulet e kurrikulës së trajnimit profesional apo trajnimeve tjera, Asetet/pajisjet e SHSK-së do të shfrytëzohen vetëm gjatë zbatimit të trajnimit profesional dhe trajnimeve tjera*”

Lista e Pajisjeve kryesore për realizimin e Kurrikulës së SHSK-së	
Pajisjet nga Akademia	Pajisjet nga SHSK-ja
• Klasa • Qasja individuale në kompjuter/lloptop dhe internet • Flipchart • Markera • Projektor	• Hapësirat e AME-së për kryerjen e praktikës profesionale

Mjetet e Kualifikimit për Zyrtar Doganor

Akademia posedon të gjitha pajisjet që janë te nevojshme për ofrimin gjegjësisht konkretizimin e kurikulës dhe moduleve të saj bazuar ne metodat me moderne për ligjërime siç janë: Klasa, Projektor, Kompjuter, Laborator, Poligone, sallat e ushtrimeve, Simulator për gjuajte me armë, Hapësira për ndihmën e parë etj.

Mirëpo Akademia me qëllim të implementimit të Kurikulës përmes vendimit të Bordit të Akademisë (*shih aneksin 13d*) ka arritë bashkëpunimin me DK-në ku të dyja Institucionet janë dakorduar që ta përkrahin njëra –tjetrën me resurset e nevojshme (*aneksi 14e – lista e pajisjeve*) për implementimin e kurikulës. Gjithashtu me Marrveshje Mirëkuptimi ndërmjet AKSP-së dhe DK-së në **nenin 7** Bashkëpunimi i ndërsjellët në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të institucioneve të Sigurisë pika 5 ku citoj “AKSP dhe DK do të mbështetin njëra tjetrën me asetet/pajisjet që kërkohen varësisht nga modulet e kurrikulës së trajnimit profesional apo trajnimeve tjera, Asetet/pajisjet e DK-së do të shfrytëzohen vetëm gjatë zbatimit të trajnimit profesional dhe trajnimeve tjera”

Lista e Pajisjeve kryesore për realizimin e Kurrikulës së DK-së	
Pajisjet nga Akademia	Pajisjet nga DK-ja
• Pajisjet e klasës • Projektori • Flipchart • Markera • Tabela e bardhë • Uniforma e kadetit • Klasa me kompjuter • Poligoni i vozitjes, • armët (pistoleta Glock 19), • municion, • uniforma, rripi zyrtar, jelek anti plumb, bateri, • mbrojtëse veshi, syze mbrojtëse, • ambulanca • Qyteza simulative • Dhoma simulative • Sallat sportive (me pajisjet përcjellëse) • Salla e kompjuterëve	• Hapësirat e DK-së për kryerjen e praktikës profesionale • • Pajisjet për ndihmë të parë - kukulla për trajnim (i rritur, foshnje, fëmijë), fashë, pajisja për frymëmarrje) • • Shenja të ndryshme njoftimi dhe paralajmëruese në aspektin doganor • • Tarifa e Integruar e Kosovës • • Kompjuter/laptop me qasje në programet ASYCUDA WORLD, COGNOS dhe SEED dhe data bazat elektronik

Financat

Burimet financiare janë transparente dhe të planifikuar në pajtim me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës, të cilat e rregullojnë buxhetin dhe çështjet financiare:

- Ligji Nr. 03/L-048 Menaxhimi i Financave Publike dhe Përgjegjësitë (*aneksin nr.10*)
- Ligji Nr.04/1-165 Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin fiskal 20 (*aneksin nr.10a*)
- Rregullat Financiare të Thesarit dhe Udhëzimet Administrative(*aneksin nr.10b*)

Në kuadër të organogramit dhe strukturës së Akademisë është divizioni për buxhet dhe financa i cili në kuadër të përgjegjësiave bën përgatitjen e propozimeve buxhetore, koordinimin me strukturat organizative të Akademisë në kërkesat e tyre buxhetore, siguron që shpenzimet financiare janë bërë në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore. Po ashtu menaxhon rezervat e parasë dhe siguron se përkundër linjave të përgjithshme buxhetore pjesës së arsimit dhe aftësimit profesional si mandatin kryesor të Akademisë ta mbuloj me kërkesat dhe nevojat buxhetore të cilat harmonizohen në planin e trajnimeve vjetore të akademisë.

Procesi i buxhetimit është si vijon:

1. Përgatitja e pasqyrave financiare për vitin e kaluar fiskal (*afati i fundit: 31.01*); (*aneksin nr.10c*)
2. Procedimi e të gjitha kërkesave për zotimin e fondeve, ekzekutimi i pagesave, rimbushja e fondit të parave të imëta; (*aneksin nr.10d*)
3. Koordinimi i të gjitha punëve me faktorët relevantë, që kanë të bëjnë me menaxhimin e Buxhetit dhe Financave në kuadër të AKSP-së dhe jashtë saj siç janë: Departamenti për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Departamenti i Buxhetit dhe Thesarit në kuadër të MF-së etj.
4. Koordinimi dhe harmonizimi i të gjitha kërkesave sektoriale për planifikimin buxhetor 2025-2027 nëpërmjet proceseve buxhetore; dhe paraqitja e tyre në sistemin e SMZHB (BDMS).
5. Përgatitja e pasqyrës së rrjedhjes së parasë; (*aneksin nr.10e*)
6. Planifikimi i projekteve kapitale për periudhën 2025 – 2027 dhe paraqitja e tyre në sistemin e PIP (programet e investimeve publike); (*aneksin nr.10f*)
7. Përgatitjet për procesin e rishikimit të buxhetit (*fundi i qershorit 2025*) (*aneksin nr.10g*)
8. Raportet periodike (javore, mujore, tremujor, gjashtëmujor, nëntëmujor edhe vjetor).

Akademia e Kosovës për Siguri Publike	Viti <u>2023</u>	Viti <u>2024</u>	Viti <u>2025</u>
	Buxhetuar	Vlerësuar	Vlerësuar
Total	3,471,123.00	3,383,633.00	3,389,423.00
Numri i punëtorëve	137	166	166
Paga dhe Mëditje	1,289,945.00	1,158,097.00	1,223,543.00
Mallra dhe shërbime	1,219,863.00	1,264,221.00	1,614,221.00
Shpenzime komunale	144,030.00	144,030.00	144,030.00
Subvencione dhe Transfere	0	0	0
Shpenzime kapitale	817,285.00	817,285.00	817,285.00
Burimet e financimit	3,471,123.00	3,383,633.00	3,799,079.00
Garantët qeveritarë	0	0	0
Të hyrat vetanake	0	0	0
Financimet nga huamarrjet	0	0	0

REZULTATET DHE TË ARRITURAT E KANDIDATËVE

Gjatë viteve **2022, 2023 dhe 2024** në Akademi janë zhvilluar **201** trajnime me ç’ rast janë trajnuar **5042** vijues. Të dhënat e paraqitura në formë tabelore paraqesin vlerësimin kualitativ të vijueseve, referuar UA Nr. 02/2012 për Trajnime dhe Zhvillim të kurrikulave (*aneksin 23*), i cili saktëson prapësin e kalueshmërisë 70%.

Viti 2022

Në vijim i kemi paraqitur në mënyrë tabelore të gjitha trajnimet e realizuara në Akademi gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2022.

Nr	Agjencia/Organizata	Numri i trajnimeve	Gjinia - Mashkuj	Gjinia - Femra	Numri i vijuesve
1	Policia e Kosovës	41	416	69	485
2	Policia e Kosovës në bashkëpunim me UNDP	2	20	9	29
3	Policia e Kosovës në bashkëpunim me Bashkimin Evropian	3	34	3	37
4	Shërbimi Korrektues i Kosovës	2	12	14	26
5	Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	9	145	4	149
6	Dogana e Kosovës	3	43	0	43
7	OSBE	4	59	9	68
8	ICITAP	1	28	7	35
9	Akademia e Kosovës për Siguri Publike (<i>përfshirë trajnimet e realizuara me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik si dhe IKAP</i>)	9	128	57	185
Numri i trajnimeve dhe vijuesëve		74	885	172	1057

Në vijim i kemi paraqitur në mënyrë tabelore vetëm trajnimet e realizuara nga Agjencitë për Siguri Publike sipas kodit të trajnimeve/kategorizimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2022.

Nr	Agjencia/Organizata	Numri i trajnimeve bazike	Numri i trajnimeve të avancuara	Numri i trajnimeve të specializuara	Numri i trajnimeve për instruktor	Numri i trajnimeve profesionale
1	Policia e Kosovës	8	30	/	3	/
2	Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	9	/	/	/	/
3	Inspektorati Policor i Kosovës	/	/	/	/	/
4	Shërbimi Korrektues i Kosovës	1	1	/	/	/
5	Shërbimi Sprovues i Kosovës	/	/	/	/	/
6	Dogana e Kosovës	3	/	/	/	/
7	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	7	1	/	1	/
Numri i trajnimeve		28	32	/	4	/

Në vijim kemi paraqitur në mënyrë tabelore vetëm numrin e vijuesëve në trajnime sipas kodit të trajnimeve/kategorizimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2022.

Nr	Agjencia/Organizata	Numri i vijuesëve në trajnime bazike	Numri i vijuesëve në trajnime të avancuara	Numri i vijuesëve në trajnime të specializuara	Numri i vijuesëve në trajnime për instruktor	Numri i vijuesëve në trajnime profesionale
1	Policia e Kosovës	159	292	/	34	/
2	Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	149	/	/	/	/
3	Inspektorati Policor i Kosovës	/	/	/	/	/
4	Shërbimi Korrektues i Kosovës	12	14	/	/	/
5	Shërbimi Sprovues i Kosovës	/	/	/	/	/
6	Dogana e Kosovës	43	/	/	/	/
7	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	154	15	/	16	/
Numri i vijuesëve		517	321	/	50	/

Viti 2023

Në vijim i kemi paraqitur në mënyrë tabelore të gjitha trajnimet e realizuara në Akademi gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2023.

Nr	Agjencia/Organizata	Numri i trajnimeve	Gjinia - Mashkuj	Gjinia - Femra	Numri i vijuesve
1	Policia e Kosovës	41	1236	197	1433
2	Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	14	316	120	436
3	Shërbimi Korrektues i Kosovës	6	78	70	148
4	Dogana e Kosovës	3	42	0	42
5	ICITAP	1	35	5	40
6	OSBE	8	112	32	144
7	Akademia e Kosovës për Siguri Publike (Trajnimet e Përbashkëta)	16	186	72	258
Numri i trajnimeve dhe vijuesëve		89	2005	496	2501

Në vijim i kemi paraqitur në mënyrë tabelore vetëm trajnimet e realizuara nga Agjencitë për Siguri Publike sipas kodit të trajnimeve/kategorizimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2023.

Nr	Agjencia/Organizata	Numri i trajnimeve bazike	Numri i trajnimeve të avancuara	Numri i trajnimeve të specializuara	Numri i trajnimeve për instruktor	Numri i trajnimeve profesionale
1	Policia e Kosovës	17	16	1	6	1
2	Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	13	/	1	/	/
3	Inspektorati Policor i Kosovës	/	/	/	/	/
4	Shërbimi Korrektues i Kosovës	4	/	/	/	2
5	Shërbimi Sprovues i Kosovës	/	/	/	/	/
6	Dogana e Kosovës	3	/	/	/	/
7	Akademia e Kosovës për Siguri Publike (Trajnimet e Përbashkëta)	11	/	/	/	/
Numri i trajnimeve		48	16	2	6	3

Në vijim kemi paraqitur në mënyrë tabelore vetëm numrin e vijuesëve në trajnime sipas kodit të trajnimeve/kategorizimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2023.

Nr	Agjencia/Organizata	Numri i vijuesëve në trajnime bazike	Numri i vijuesëve në trajnime të avancuara	Numri i vijuesëve në trajnime të specializuara	Numri i vijuesëve në trajnime për instruktor	Numri i vijuesëve në trajnimeve profesionale
1	Policia e Kosovës	662	209	20	109	433
2	Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	422	/	14	/	/
3	Inspektorati Policor i Kosovës	/	/	/	/	/
4	Shërbimi Korrektues i Kosovës	56	/	/	/	92
5	Shërbimi Sprovues i Kosovës	/	/	/	/	/
6	Dogana e Kosovës	42	/	/	/	/
7	Akademia e Kosovës për Siguri Publike (Trajnimet e Përbashkëta)	186	/	/	/	/
Numri i vijuesëve		1368	209	34	109	525

Viti 2024

Në vijim i kemi paraqitur në mënyrë tabelore të gjitha trajnimet e realizuara në Akademi gjatë periudhës Janar-Shtator të vitit 2024.

Nr	Agjencia/Organizata	Numri i trajnimeve	Gjinia - Mashkuj	Gjinia - Femra	Numri i vijuesve
1	Policia e Kosovës	17	901	214	1115
2	Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	6	86	5	91
3	Dogana e Kosovës	3	39	0	39
4	Shërbimi Korrektues i Kosovës	2	56	25	81
5	OSBE	4	33	27	60
6	Zyra e Programeve Ndërkombëtare të Shërbimit Pyjor të Departamentit të Bujqësisë së SHBA	1	18	0	18
7	Akademia e Kosovës për Siguri Publike (<i>Trajnimet e Përbashkëta</i>)	5	42	38	80
Numri i trajnimeve dhe vijuesëve		38	1175	309	1484

Në vijim i kemi paraqitur në mënyrë tabelore vetëm trajnimet e realizuara nga Agjencitë për Siguri Publike sipas kodit të trajnimeve/kategorizimit gjatë periudhës Janar-Shtator të vitit 2024.

Nr	Agjencia/Organizata	Numri i trajnimeve bazike	Numri i trajnimeve të avancuara	Numri i trajnimeve të specializuara	Numri i trajnimeve për instruktor	Numri i trajnimeve profesionale
1	Policia e Kosovës	6	8	2	1	/
2	Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	6	/	/	/	/
3	Inspektorati Policor i Kosovës	/	/	/	/	/
4	Shërbimi Korrektues i Kosovës	1	/	/	/	1
5	Shërbimi Sprovues i Kosovës	/	/	/	/	/
6	Dogana e Kosovës	3	/	/	/	/
7	Akademia e Kosovës për Siguri Publike (<i>Trajnimet e Përbashkëta</i>)	5	/	/	/	/
Numri i trajnimeve		21	8	2	1	1

Në vijim kemi paraqitur në mënyrë tabelore vetëm numrin e vijuesëve në trajnime sipas kodit të trajnimeve/kategorizimit gjatë periudhës Janar-Shtator të vitit 2024.

Nr	Agjencia/Organizata	Numri i vijuesëve në trajnime bazike	Numri i vijuesëve në trajnime të avancuara	Numri i vijuesëve në trajnime të specializuara	Numri i vijuesëve në trajnime për instruktor	Numri i vijuesëve në trajnimeve profesionale
1	Policia e Kosovës	961	87	40	27	/
2	Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	91	/	/	/	/
3	Inspektorati Policor i Kosovës	/	/	/	/	/
4	Shërbimi Korrektues i Kosovës	17	/	/	/	64
5	Shërbimi Sprovues i Kosovës	/	/	/	/	/
6	Dogana e Kosovës	39	/	/	/	/
7	Akademia e Kosovës për Siguri Publike (<i>Trajnimet e Përbashkëta</i>)	80	/	/	/	/
Numri i vijuesëve		1188	87	40	27	64

Në vijim kemi paraqitur të dhënat vetëm për trajnimet nga Agjencitë e Sigurisë Publike (PK, AME, IPK, ShKK, ShSK, DK, AKSP)

AGJENCITË E SIGURISË PUBLIKE	Numri i trajnimeve			Numri i vijuesëve		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024
Policia e Kosovës (duke përfshirë edhe trajnimet e realizuara në bashkëpunim me organizata ndërkombtare)	46	41	17	551	1433	1115
Agjencia e Menaxhimit Emergjent	9	14	6	149	436	91
Inspektorati Policor i Kosovës	/	/	/	/	/	/
Shërbimi Korrektues i Kosovës	2	6	2	26	148	81
Shërbimi Sprovues i Kosovës	/	/	/	/	/	/
Dogana e Kosovës	3	3	3	43	42	39
Akademia e Kosovës për Siguri Publike (duke përfshirë edhe trajnimet e realizuara në bashkëpunim me organizata/institucione tjera)	9	16	5	185	258	80
Gjithsej	69	80	33	954	2317	1406

**Korniza Kombëtare për Sigurim të Cilësisë për:
Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP)**

Emri i IAAP	Akademia e Kosoves per Siguri Publike					
Adresa: Emali: Telefoni:	Rr. “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” P.n. 42000 Vushtrri, Republika e Kosovës. Informatat kontaktuese të AKSP-së janë: Telefoni +381 (0)28 590 070, www.aksp-ks.net					
Periudha e vet-vlerësimit	Viti: 2024	Nga muaji;	Janar			
		Deri në muajin:				
Cikle të vet-vlerësimit të zhvilluara deri me tani						
Parimet e Cilësisë	Përgjegjësitë e menaxhmentit	Menaxhimi i resurseve	Hartimi dhe zhvillimi	Ofrimi, Vlerësimi dhe Certifikimi	Procesi i vet-vlerësimit	Procesi për përmirësim
Mesatarja e vlerësimit (nota1 mesatare)	3.13	3.00	3.50	3.20	3.00	3.00
Kualifikimet që ofrohen	- Zyrtar Policor, - Zyrtar Doganor, - Zyrtar Korrektues, - Zyrtar Sprovues, - Zjarrfikës, - Inspektor i IPK-se,					
Emri, mbiemri i drejtorit dhe nënshkrimi	Kastriot Jashari zv. Drejtor i Pergjithshem i AKSP-se					

1 Përshkrimi i notave:

4 - Përparësi: realizim shumë i mirë, që është mbi kërkesat optimale dhe mbi nivelin e pritur të performancës/realizimit, që mbështetet me dëshmi;

3 - Mirë: realizim i kënaqshëm, që përmbushë kërkesat optimale që ka mundësi të zhvillohet në përparësi, që mbështetet me dëshmi;

2 - Mjaftueshëm: pjesërisht i kënaqshëm, i përmbushë kërkesat minimale, ka nevojë për përmirësim dhe adaptim;

1 - Jo i mjaftueshëm: realizim jo i mjaftueshëm, që nuk i përmbushë kërkesat, ekzistojnë zbrazëtira (mangësi) serioze, që duhet të merren në konsideratë për përmirësim.

Emri, mbiemri i koordinatorit për sigurimin e cilësisë dhe nënshkrimi		Emin Uka Udhëheqës i DSC-se/Koordinator i Cilësisë			
PARIMI I CILËSISË 1 – PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT					
Nr	TREGUESIT	NOTIMI			VLERËSIMI/DËSHMIA
.					
1	Menaxhmenti zhvillon dhe zbaton misionin, vizionin dhe objektivat strategjike të institucionit për rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit në punë, me të gjithë personelin dhe palët e interesit.		3		AKSP-ja është duke zbatuar misionin, vizionin dhe vlerat e saja të cilat janë të pasqyruara në Strategjinë Zhvillimore dhe Planin e Veprimit të AKSP-së për vitet 2023 – 2026. Strategjia Zhvillimore e Akademisë është bazuar në parimet që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, legjislacioni në fuqi, si dhe në instrumentet ndërkombëtare. Strategjia e AKSP-së është bazuar edhe në praktikën më të mira të institucioneve të akredituara në fushën e sigurisë publike, duke aplikuar standardet më të avancuara ndërkombëtare. Në procesin e hartimit po ashtu janë inkuadruar të gjitha palët e interesit si dhe partnerë tanë ndërkombëtar. Menaxhmenti ka realizuar disa aktivitete lidhur me njoftimin e stafit rreth misionit, vizionit dhe vlerave duke i dërguar dhe transmetuar tek të gjithë stafi përmes dokumenteve të hartuara, publikimeve të vendosura në pika kyçe të objekteve si dhe përmes takimeve të punës dhe publikimi në web faqe. Me qëllim të arritjes së qëllimeve strategjike, misionit dhe vizionit të AKSP-së janë ndërmarrë edhe shumë veprime dhe janë hartuar edhe shumë dokumente si:

					Plane vjetore, plane të performancës, monitorime, raporte etj. AKSP si institucion përgjegjës për ngritjen e kapaciteteve të Institucioneve të Sigurisë Publike, si një nga vlerat më të larta njerëzore dhe profesionale konsideron Integritetin. Integriteti kuptohet si promotor i jetës i cili na përcjellë në çdo sferë, andaj edhe ushtrimi i funksioneve dhe detyrave me integritet nga zyrtarët e AKSP-së krijon besueshmëri tek qytetarët, palët e interesit dhe partnerët tanë ndërkombëtar. Tashmë kanë filluar edhe proceset planifikuese për vitin 2025 ku aktivitetet strategjike shëndrrohen në aktivitetet vjetore ku janë themeluar edhe grupet për hartimin e dokumenteve si: Plani i punës së AKSP për vitin 2025, - Plani i veprimit për vitin 2025, - Lista e rrezikut për vitin 2025, - Plani Integritetit - Plani Performancës së AKSP 2025 <u>Dokumentet:</u> - Vendimi për miratimin e Strategjisë Zhvillimore për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe planit të veprimit për vitin 2023-2026. - Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit të AKSP-së për vitet 2023 – 2026, - Zbërthimi i kornizës strategjike Mision, Vizion dhe vlerat 2023-2026 - Plani i komunikimit të strategjisë - Plani i punës së AKSP për vitin 2024, - Plani i veprimit për vitin 2024,
--	--	--	--	--	---

					- Lista e rrezikut per vitin 2024, - MPB raportet dhe planifikimet mujore per vitin 2024 - Draft –Plani i performancës për vitin 2024 - Vendimi i themelimit të grupit punues për hartimin e planeve AKSP 2025 - Vendimi për themelimit të grupit punues për hartimin e planit Integritetit AKSP 2024-2026
2	Menaxhmenti vazhdimisht përcjell dhe monitoron të arriturat e objektivave strategjike dhe performancën institucionale.		3		Në bazë të monitorimit dhe vlerësimit hartohen raporte me rekomandime dhe planet për përmirësimin e cilësisë të programet mësimor. AKSP ka hartuar edhe udhëzuesin për planifikim, monitorim dhe raportim të aktiviteteve të saja. Po ashtu behet vlerësimi i performancës menaxheriale duke ndërmarrë këto aktivitete si ne vijim: ne çdo fillim te vitit hartohet plani i punës konform objektivave strategjike, ndryshimeve të monitoruara, raporteve monitoruese etj ku në periudha periodike behet edhe monitorimi dhe vlerësimi i realizimit te aktiviteteve te atij plani si dhe objektivave strategjike me qellim qe te kemi një pasqyre reale rreth orientimit dhe arritjeve. AKSP ofron raporte periodike dhe planifikime edhe ne baza mujore ne MPB. AKSP-ja ka ndërtuar sistemin e sigurimit të cilësisë e cila përmes DSC-se bën monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë te programeve mësimore dhe ate insititucionale. <i>Dokumentet:</i> - MPB raportet dhe planifikimet mujore per vitin 2024

						- Raporte periodike mbi monitorimin e zbatimit të aktiviteteve planifikuese - Raportimi per PVP AKSP-TM1-TM2, - Model Raporti i punës TM1- TM2 2024 Janar-Qershor - Raporti Vjetor i punës AKSP 2023 - Raporti vjetor i vlerësimit dhe zbatimit të Planit të Veprimit strategjik 2023 - Udhëzuesi për procedurat e planifikimit, monitorimit, vlerësimit dhe raportimit në AKSP - Doracaku i cilesise - Plani i vjetor i punes se DSC per vitin 2025 - Raportet e pergjithshme vjetore per trajnime dhe mjedis arsimor
3	Menaxhmenti monitoron dhe mbështetë të arriturat e nxënësve/kandidatëve dhe mësimdhënësve/trajnerëve		3			Në grupet punuese për hartimin e programeve mësimore janë përfshirë ekspertë vendor të ISP-ve, dhe AKSP- së. <i>Dokumentet:</i> - Vendimi i krjimit te grupeve punuese per SP, - Vendimi i krijmit te grupit punues per kurrikula

4	Menaxhmenti planifikon buxhetin (me prioritet për ofrimin cilësor të kualifikimeve përkatëse), menaxhon obligimet financiare si dhe i nënshtrohet kontrolleve të rregullta financiare.		3		Planifikimi, Menaxhimi , Organizimi ,Kontrolli dhe Ekzekutimi i Buxhetit në kuadër të AKSP-së është në pajtueshmëri të plotë me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë , Rregulloret dhe Udhëzimet financiare të aplikueshme në Republikën e Kosovës. AKSP përdor sistemin SIMFK për menaxhimin e të dhënave buxhetore . Menaxhimi i kontrollit financiar i AKSP- së i është nënshtruar edhe kontrollit dhe monitorimit nga Njësia Qëndrore Harmonizuese/NJQH-MF <i>Dokumentet:</i> - Raporti nga Monitorimi i NJQH-MF për Menaxhimin e kontrollit financiar të AKSP per vitin 2025- shtator 2027 - Pasqyrat financiare KASH 2024 - Planifikimet financiare 2025-2027 - PCF 2- 2025 -2027, - PCF 3- 2025 – 2027, - Raporti javor për MPB, - Raporti mujor për Kabinetin e Ministrit, - Raporti mbi procesin e pajtueshmërisë së regjistrave kontabël ne SIMFK /MFPT, - Raporti tremujor për MPB, - Raporti gjashtëmujor për MPB, - Raporti nëntëmujor për MPB, - Raporti vjetor financiar 31 Dhjetor 2024
5	Menaxhmenti krijon dhe rritë bashkëpunimin dhe partneritetin me ofruesit tjerë të AAP, agjencitë relevante dhe pale të tjera të interesit.	4			Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) ka arritur dhe vazhdon të përkrahet përmes

					formave apo programeve dhe fondeve të ndryshme në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Sa i përket të përfshirëve në aktivitetet e Erasmus+, vitin e kaluar (2021), AKSP ka arritur që të dërgojë 6 pjesëtarë të vet jashtë shtetit përmes këtij programi, dhe atë nga 2: studentë, pjesëtarë të stafit akademik dhe të atij administrativ. Përderisa, për dallim nga viti praparak, në këtë vit (2024) ka pasur gjithsej 20 të shkëmbyer, prej të cilëve 8 pjesëtarë ardhës (5 të stafit administrativ e 5 të tjerë të stafit akademik) dhe 12 shkues (prej të cilëve 4 studentë, 2 të stafit akademik dhe 6 të tjerë të atij administrativ). Përderisa, për dallim nga vitet paraprake, në vitin 2023 AKSP ka pasur këto aktivitete në kuadër të Erasmus+: -Qëndrim Mobiliteti në AKSP për një semestër i 2 studentëve nga Laurea Universiteti i Shkencave të Aplikuara (USHA) nga Finlanda -Qëndrim Mobiliteti në AKSP i 8 prej stafit të LAUREA UAS nga Finlanda. -7 staf dhe 1 ligjerues i AKSP-së në mobilitet stafi në Laurea UAS në Finland Sa i përket të përfshirëve në aktivitetet e CEPOL, në këtë vit (2024), përmes koordinimit me AKSP, në mënyrë të suksesshme kanë përfunduar trajnimin 4 staf të zbatuesve të ligjit të Kosovës dhe 2 staf të tjerë të zbatuesve të ligjit në kuadër të CEPOL programit të shkëmbimit.
--	--	--	--	--	---

					<i>Dokumentet:</i> Bashkëpunimi ndërkombëtar i formalizuar me organizata dhe institucione si ne vijim: - Asociacioni i Kolegjeve Policore Evropiane (AEPC) https://www.aepc.net - Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnim në Zbatimin e Ligjit (CEPOL) https://www.cepoleuropa.eu, - Asociacioni Evropian i Kolegjeve të Shërbimit të Zjarrfikjes (EFSCA) http://www.efsc.org/SitePages/Home.aspx - Rrjeti Ndërkombëtar Frankofon i Trajnimit Policor (FRANCOPOL) http://www.franccopol.org - Asociacioni Ndërkombëtar i Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimit të Zbatimit të Ligjit (IADLEST) https://www.iadlest.org - Asociacioni Ndërkombëtar i Akademive Policore (INTERPA) http://www.interpa.org <i>(AKSP është njëra prej 22 institucione themeluese të INTERPA)</i> - Kolegji Universitar Policor i Finlandës http://www.polamk.fi - Akademia e Sigurisë së Shqipërisë http://www.asp.gov.al, - Instituti i Trajnimit i Shërbimeve Korrektues dhe Sprovues http://www.rskk.fi/fi - Universiteti Laurea i Shkencave të Aplikuara https://www.laurea.fi - Akademia Policore e Malit të Zi http://www.policijaskaakademija.me
--	--	--	--	--	---

					- Fakulteti i Sigurisë i Universitetit “St. Kliment Ohridski” në Maqedoninë Veriore http://www.fb.uklo.edu.mk - Qendra e Trajnimit Policor e Ministrisë së Punëve të Brendshme e Maqedonisë së Veriut https://mvr.gov.mk/profilepage/pomoshnik-minister-co <u>Bashkëpunimi ndërkombëtar i paformalizuar me organizata dhe institucione si ne vijim:</u> - Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë https://www.dcaf.ch - Kolegji Policor i Brandenburgut https://hpolbb.de - Shkolla Kryesore e Shërbimit të Zjarrfikjes e Polonisë https://www.sgsp.edu.pl - Kolegji Universitar Policor i Norvegjisë https://www.politihogskolen.no - Universiteti Policor i Gjermanisë https://www.dhpol.de - Akademia Policore e Saksonisë së Ulët, Gjermani https://www.pa.polizei-nds.de/startseite - Qendra për Siguri Publike e Universitetit Northwestern, SHBA https://sps.northwestern.edu/center-for-public-safety - Universiteti Utah Valley, SHBA https://www.uvu.edu Bashkëpunimi i formalizuar vendor (kombëtar) me institucione dhe organizata si ne vijim:
--	--	--	--	--	---

					- Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina https://www.uni-pr.edu - Universiteti i Gjilanit Kadri Zeka https://www.uni-gjilan.net; - Kolegji AAB https://www.aab-edu.net - Akademia e Drejtësisë https://www.ad.rks-gov.net - Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” https://www.biblioteka-ks.org - Universiteti i Mitrovicës Isa Boletini https://www.umib.net - Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (Advocacy Training And Resource Center – ATRC) https://advocacy-center.org- - Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës
6	Menaxhmenti përfshihet apo zhvillon projekte të ndryshme me qëllim zhvillimi, trajnimi, punësimi, mobilitet, etj. në nivel vendor dhe ndërkombëtar (vlen për ofruesit formal të AAP).	4			Akademia ka arritur të jetë përfutuese dhe zhvilloj projekte, bashkëpunime dhe marrëveshje me partnerë vendorë dhe ndërkombëtar të cilat kanë kontribuar në zhvillimin institucional dhe profesional, me karakter vendor, rajonal dhe atë të nivelit ndërkombëtar (evropian dhe me gjërë). Bashkëpunimin e formalizuar vendor me institucione dhe organizata e paraqesim si në vijim: -Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Republikës së Kosovës -Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (Advocacy Training And Resource Center – ATRC) https://advocacy-center.org- Bashkëpunimi i pa-formalizuar vendor me

					institucione dhe organizata si ne vijim: -Akademia e Drejtësisë https://www.ad.rks-gov.net -Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) Ministria e Punëve të Brendshme Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucione dhe organizata si ne vijim me të cilat bashkëpunojm dhe bashkëpordinohe mi për zhvillimin e trajnimeve, projekteve të ndryshme të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe institucionale në përfitim për AKSP-në dhe zbatuesit e ligjit në Republikën e Kosovës: -Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri me Mision në Kosovë (OSBE) https://www.osce.org/mission-in-kosovo -Programi Ndërkombëtar i Përkrahjes së Trajnimit të Hetimit të Krimit (ICITAP) https://www.justice.gov/criminal/criminal-ICITAP -Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnim në Zbatimin e Ligjit (CEPOL) https://www.cepol.europa.eu, -Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë - EULEX (European Union Rule of Law Mission in Kosovo): https://www.eulex-kosovo.eu/ -LAUREA University of Applied Sciences, Finlandë https://www.laurea.fi/ . Në kuadër të aplikimit të projekteve në fodet e BE-së, AKSP është nismëtare me LAUREA për një projekt madhor ku përfshihen një numër i madh partnerësh ndërkombëtar nga rajoni dhe
--	--	--	--	--	---

					Evropa ku Institucionet respektive nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut janë përfshirë si impakt pozitiv i AKSP-së. Projekti ka të bëjë në kuadër të luftimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit, ku pjesa ku përfshihet AKSP me vendet e rajonit dhe LAUREA, është fusha e luftimit të Trafikimit me qenie njerëzore. - AKSP është e përfshirë në projektin e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent (AME-së) në kuadër të projektit Erasmus+ "GROWTH" (01.01.2023 - 31.12.2025), ku do të zhvillohen, dizajnohen dhe mbahen trajnime të karakter me pjesëmarrje dhe online në fushën e emergjencave. Akademia ka arritur të jetë përfituese dhe zhvilloj projekte, bashkëpunime dhe marrëveshje me partnerë të cilat kanë kontribuar në zhvillimin lokal, rajonal dhe atë të nivelit ndërkombëtar Evropian.
7	Menaxhmenti shqyrton dhe analizon të dhënat me karakter social, ekonomik, demografik, ligjor dhe ekologjik si dhe i përdor ato për zhvillime strategjike.		3		AKSP-ja në mënyre të vazhdueshme bën mbledhjen e informatave rreth ndryshimeve të rëndësishme si ato sociale, ekologjike, ekonomike, ligjore dhe demografike, ku të njëjtat i inkorporon në planin e saj të punës duke i caktuar prioritetet në bazë të kërkesave të palëve të interesit. Secila njësi bënë monitorimin e ndryshimeve të lartcekura sipas fushëveprimit të saj dhe njëkohësisht njoftohen të gjithë akteret relevant në AKSP. Kjo realizohet edhe konformë procedurave të brendshme të miratuara për Monitorimin dhe Njoftimin e Ndryshimeve nga Jashtë. - Dëshmi mbi monitorimin e ndryshimeve ligjore,

					- Dëshmi mbi monitorimin e ndryshimeve strategjike - Vendimi 282 /2023 për Përcaktimin e Procedurave për Monitorimin dhe Njoftimin e Ndryshimeve nga Jashtë - Rregullorja 05/2014 për organizimin e brendshëm, - Njoftimi për planin e trajnimeve 2023 - Njoftimi për zhvillimin e trajnimeve (njoftimi i rregullt javor)
8	Menaxhmenti përdor të dhëna për zhvillime strategjike.		3		Në bazë të strategjisë zhvillimore dhe Planit të Veprimit të AKSP-së grumbullohen dhe analizohen të dhënat për të cilat çdo fund vit hartohet raporti i cili pasqyron gjendjen reale të Institucionit dhe i njëjti shërben si mekanizëm për hartimin e planit për përmirësim dhe adaptim të planit vjetor të punës së AKSP-së për vitet vijuese. Po ashtu plani i punës së AKSP-së bazohet edhe në dokumente tjera strategjike dhe ligjore ku kërkesat dhe nevojat e tyre i adapton me aktivitetet dhe objektivat vjetore <i>Dokumentet:</i> - Raporti vjetor i punës së AKSP 2023 - Raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të strategjisë zhvillimore të AKSP-së (për vitin 2023) - Raporti vjetor 2023 i vlerësimit të zbatimit të Planit të Përformancës AKSP

9	Menaxhmenti mbështetë dhe monitoron sistemin e të dhënave lidhur me sigurinë, saktësinë dhe rifreskimin e tyre.		3		AKSP ka sistemin e vet të informimit përmes WEB faqes së saj dhe komunikimit të brendshëm. Të gjitha të dhënat verifikohen, regjistrohen dhe mirëmbahen në mënyre elektronike në data-bazë si dhe në mënyrë fizike në arkiv, për të gjitha aktivitetet e trajnimeve që zhvillohen në AKSP. Të gjitha të dhënat mbahen në vende të sigurta dhe të besueshme, kontrollohen dhe shqyrtohen në mënyrë të rregullt. <i>Dokumentet:</i> -Përshkrimi i punës së DTI, -UA për llogaritë elektronike zyrtare, -UA mbi sigurinë dhe qasjen në bazat e të dhënave, -UA për menaxhimin dhe përdorimin e internetit, -Rregullore për standarde për Sistemet e sigurisë së pajisjeve, -Vendimi për grupin punës për siguri kibernetike.
10	Menaxhmenti zhvillon dhe mirëmbanë sistemin e sigurimit të cilësisë përmes politikave, procedurave, rregulloreve dhe udhëzimeve të ndryshme.		3		Planet strategjike dhe operative, aktet dhe udhëzimet e cilësisë janë të përfshira në sistemin e sigurimit të cilësisë: <i>Doracaku i Cilësisë, Manuali për Praktik Profesionale i Sigurisë Publike.</i> <i>Dokumentet:</i> -Doracaku i cilësisë, -Korniza logjike,

					-Raporti i përgjithshëm vjetor i vlerësimit të trajnimeve, (raporti në vete pasqyron vlerësimin e ndare sipas kategorive në Akademi: - trajnimet profesionale, - trajnimet bazike, - trajnimet e avancuar, - trajnimet e specializuar, - trajnimet për instruktor, sipas ISP-ve dhe PN-ve -trajnimet për Policinë e Kosovës, -trajnimet për Sherbimin Korrektues, -trajnimet për Sherbim Sprovues, -trajnimet për Inspektorat të PK, -trajnimet për Agjencinë e Emergjencave të Kosovës, -trajnimet për Doganën e Kosovës, -trajnimet nga Partneret Ndërkombëtar-ICITAP, OSBE, -vlerësimin e mjedisit arsimor në trajnime, -Raporti i përmbledhur mbi kënaqshmërinë e personelit në AKSP, -Raporti vjetor i punës së AKSP, -Raporti vjetor i punës së DSC.
11	Menaxhmenti përcakton dhe emëron personin/personat përgjegjës për sigurim të cilësisë.		3		Në bazë të Nenit 21 të Rregullores (QRK) Nr.05/2014 për organizimin e brendshëm të AKSP-së, DSC është përgjegjës për sigurimin e cilësisë. <i>Dokumentet:</i>

						-Rregullorja 05/2014 per organizimin e brendshëm, -Organogrami i AKSP, -Pershkrimi i DSC-se, -Pershkrimi i pozitave ne kuader te DSC-se. -Vendimi per emertimin e Koordinatorit te Cilesise
12	Menaxhmenti dhe i tërë personeli janë të angazhuar për të siguruar se sistemi për menaxhimin e cilësisë zbatohet dhe vazhdimisht përmirësohet.		3			Akademinë e Kosovës për Siguri Publike konform obligimit ligjor (neni 13 pika 1.7 të Ligjit Nr.04/L-053) ka zhvilluar sistemin e i menaxhimit të brendshëm të cilësisë. <i>Dokumentet:</i> -Doracaku i cilësisë, -Raportet periodike nga DSC, -Plani i punes se DSC, -Plani i veprimit te DSC.
13	Zbatimi i politikave për rekrutim të personelit realizohet sipas kërkesave të kualifikimeve përkatëse dhe legjislacionit në fuqi.		3			Personeli punësohet sipas kriterëve të përcaktuara me dispozitat e Ligji 08/L-197 për Zyrtar Publik, si dhe akteve nenligjore rregulloreve te cilat rrjedhin na ky ligj ku përveç mundësive të barabarta për përzgjedhje ofrohet edhe transparencë dhe inkurajim të barazisë gjinore dhe respektimin e të drejtave të minoriteteve. <i>Dokumentet:</i> - Ligji per zyrtaret publik 08/L-197 - Rregulloret (te cilat dalin na ligji) - Plani i personelit, - Plani i Trajnimeve

14	Menaxhmenti zhvillon politika për zhvillim profesional të mësimdhënësve/trajnerëve		3			Menaxhmenti me qëllim të rritjes së të arriturve të mësimdhënësve, ka hartuar planin e trajnimeve mbi nevojat e stafit në kuader të AKSP dhe I njëjti implementohet përgjate vitit. <i>Dokumentet:</i> - Plani i zhvillimit të personelit, - Lista e trajnimeve të ndjekura nga instruktoret e AKSP, - Plani i trajnimeve mandatore - Tabela e trajnimeve të zhvilluara në vend - Tabela e trajnimeve të zhvilluara jashtë vendi.
15	Institucioni zbaton proces efikas të kërkesave dhe ankesave (nxënësve/kandidatëve, mësimdhënësve dhe palëve me interes).		3			Grupi punues për hapjen e kutive të vërejtjeve, ankesave dhe sugjerimeve në AKSP. AKSP në kuader të shqyrtimit të ankesave, vërejtjeve dhe disiplinës ka krijuar organet shqyrtuese. <i>Dokumentet:</i> - Vendimi për themelimin e komisionit disiplinor në AKSP - Vendimi për themelimin e komisionit për hapjen e kutive të aneksave, vërejtjeve dhe sugjerimeve në AKSP
PARIMI I CILËSISË 2 - MENAXHIMI I RESURSEVE						
Nr	TREGUESIT	NOTIMI			VLERËSIMI/DËSHMIA	
.						
1	Kualifikimi ofrohet në ambient të sigurtë dhe të përshtatshëm.		3			Të gjitha hapësirat, pajisjet dhe materialet në Akademi ofrojnë ambient të sigurt për zhvillimin e kualifikimit.

					Akademia e ka planin e reagimit emergjent duke përfshirë edhe planin e evakuimit, ku përfshihen procedurat e raportimit të incidenteve (shih dokumentin e bashkangjitur). I gjithë kampusi i AKSP-së është i rrethuar me qëllim të ofrimit të sigurisë dhe i njëjti menaxhohet 24/7 nga Divizioni i Sigurimit i cili përmes pranisë fizike dhe vëzhgimit nga sistemi CC-TV kontrollon sigurinë e hapësirave. Personeli i Akademisë (Divizioni i Sigurimit) i ndjek trajnimet e ndihmës së parë dhe trajnimin për përdorimin e mjeteve themelore për shuarjen e zjarrit për të cilët edhe janë të certifikuar. Në rastet emergjente stafi i sektorit të sigurimit shndërrohet në menaxher të situatave emergjente duke luajtur rol kyç në evakuimin dhe orientimin e personelit, vijuesve konform rregullave të Planit Emergjent. Në lidhje me procedurat dhe udhëzimet e rasteve emergjente informohen paraprakisht në fillim të trajnimeve përmes broshurave dhe prezantimeve tek të gjithë vijuesit. Në kuadër të strukturës organizative të Akademisë funksionon edhe sektori i mjekësisë (një mjek dhe dy teknik mjekësor) i cili sektor përveç ofrimit të shërbimeve mjekësore për të gjithë personelin që gjendet në AKSP, po ashtu mbështesin të gjitha trajnimet Të gjitha ambientet e mbyllura janë të pajisura me sistemin e alarmit kundër zjarrit. Akademia posedon sistemin e hidrantëve dhe aparateve kundërzjarrit si dhe shkallët emergjente në ndërtesat e larta (konviktet e banimit). Jemi në proces duke përmirësuar shkallët emergjente.
--	--	--	--	--	---

					Akademia posedon sistemin e informimit automatik përmes telefonisë fikse për rreziqe eventuale (zjarret, tërmetet e tjera). Po ashtu përveç planit për reagimin emergjent AKSP-ja aplikon edhe standardet dhe kriteret konform rregullores për kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë. <i>Dokumentet:</i> - Raportet periodike nga Sigurimi, - Plani i reagimit emergjent, - SOP e sektorit mjekësor, - Raporti vjetor i sektorit mjekësor.
2	Pajisjet, materialet janë të përshtatshme për kualifikimin përkatës sipas kërkesave të tregut të punës.		3		Kadetëve ju garantohen të gjitha kushtet e përshtatshme për mësim dhe akomodim përmes infrastrukturës fizike (klasave mësimore, konvikteve të banimit për meshkuj dhe femra) pajisjeve për mësim (smart bord, projektor, simulimi i trajnimit me arme zjarri, dhoma simulative për ushtrime në vendin e ngjarjes, lab. forenzikës, kabineti i IT-së, biblioteka, etj.) lista e pajisjeve të agjencive. <i>Dokumentet:</i> - Raporti i përgjithshëm për asetet e AKSP - Lista e pajisjeve për trajnim.
3	Kushtet e punës dhe ambientet e mësimit dhe metodat e mësimdhënies janë të qasshme dhe adekuate për të gjitha grupet e nxënësve/kandidatëve.		3		AKSP posedon Master Planin e Kampusit dhe ka të vendosur një tabelë orientuese në hyrje të kampusit si dhe tabelat orientuese për të gjitha objektet përkatëse. Po ashtu AKSP posedon planin e reagimit emergjent ku përfshihen mënyrat e evakuimit, pika e tubimit, njohjame

					procedurat e alarmit në raste zjarri apo fatkeqësive natyrore si dhe ekzistojnë kushtet për qasje. Po ashtu jemi në proces të konkretizimit të master planit me shenja orientuese për qasje në objekte brenda kampusit. Gjate periudhës së pandemisë AKSP ka aplikuar të gjitha rekomandimet e MSH dhe IKSHPK-se lidhur me masat dhe distancën. <i>Dokumentet:</i> - Master plani i AKSP, - Plani i reagimit emergjent.
4	Kodi i mirësjelljes tregon përgjegjësitë dhe të drejtat e personelit mësimdhënës dhe administrativ.		3		<i>DBNJ në vazhdimësi informon stafin për respektimin e kodit të etikës.</i> -RREGULLORE NR. 39/2012 PËR KODIN E ETIKËS NË AKADEMINË E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE
5	Zbatimi i politikave për zhvillim profesional të mësimdhënësve/trajnerëve ndikon në rritjen e cilësisë.		3		Në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për Shërbimin Civil, çdo vite përgatitet Plani i Trajnimeve (zhvillimit) për personelin e AKSP-së. Vijimi i trajnimeve kontribuon dukshëm në efikasitetin e punës. Në kuadër të planit të trajnimeve, bëjnë pjesë edhe trajnimet që planifikohen për personelin trajnues si: Programi për aftësimin e instruktoleve, Trajnimi për Trajner (TPT), etj. <i>Dokumentet:</i> -Plani i trajnimeve për stafin e AKSP- së, -Tabela e trajnimeve të zhvilluara në vend, -Tabela e trajnimeve të zhvilluara jashtë vendit.

PARIMI I CILËSISË 3 –DIZAJNIMI DHE ZHVILLIMI

Nr .	TREGUESIT	NOTIMI	VLERËSIMI/DËSHMIA			
1	Programet e mësimi plotësojnë qëllimet dhe karakterin strategjik të organizatës.	4				Programet mësimore i plotësojnë qëllimet strategjike dhe organizative të agjencive dhe atë pasi që Trajnimi është zhvilluar nga Standardi i profesionit të zyrtarit përkatës bazuar në nevojat e agjencive. <i>Dokumentet:</i> -Standardet e profesionit të aprovuara nga KAAPR -Vendimi për valdim dhe akreditim të AKSP -Vendimi për akreditim ndërkombëtar nga IADLEST
